**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2262/2 Prot. Rrëshen më, 23.06.2025

**V E N D I M**

**Nr. 51 datë 19. 06. 2025**

**PËR**
**"MIRATIMIN NË PARIM TË DRAFT MEMORANDUM PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI TË NDËRSJELLË, NDËRMJET BASHKISË MIRDITË, SHQIPËRI DHE BASHKISË PEZINOK, SLLOVAKI"**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe VKM nr. 734, datë 09.09.2015 "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore" pikat 9 dhe 11/c; Relacioni nr. 2262 prot, datë 11.06.2025, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit e diskutimeve në mbledhjen e datës 19.06.2025 të Këshillit Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimi në parim i draft Memorandum Partneriteti dhe Bashkëpunimi të Ndërsjellë me Bashkisë Pezinok në Sllovaki

2. Memorandumi i Partneritetit dhe Bashkëpunimit të Ndërsjellë është ekuivalent me Marrëveshje Binjakëzimi

3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Z. Albert Mëlyshi për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Mirditë, Shqipëri dhe Bashkisë Pezinok, Sllovaki

4. Relacioni nr. 2262 prot, datë 11.06.2025 dhe dokumentet shoqërues, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*

5. Të ngarkohet Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

**S E K R E T A R**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**
**Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2262/1 Prot. Rrëshen me, 11.06. 2025

**P/VENDIM**
**Nr. 56 ., datë 11.06.2025**

**PËR**
**"MIRATIMIN NË PARIM TË DRAFT MEMORANDUM PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI TË NDËRSJELLË, NDËRMJET BASHKISË MIRDITË, SHQIPËRI DHE BASHKISË PEZINOK, SLLOVAKI"**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe Vendimin Nr. 734., datë 09.09.2015 "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore" pikat 9 dhe 11/c; Relacioni sëbashku me projektvendimin për të shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve.,

**VENDOSi:**

1. Miratimi në parim i draft Memorandum Partneriteti dhe Bashkëpunimi të Ndërsjellë me Bashkisë Pezinok në Sllovaki.
2. Memorandumi i Partneritetit dhe Bashkëpunimit të Ndërsjelltë është ekuivalent me Marrëveshje Binjakëzimi.
3. Autorizimin e kryetarit të Bashkisë Z. Albert Mëlyshi për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Mirditë, Shqipëri dhe Bashkisë Pezinok, Sllovaki.
4. Të ngarkohet Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.*

**SEKRETAR** **KRYETAR**
**Gasper TOPOLLAJ** **Aleksandë PICAKU**

***Paraqiti Projektin:***
Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/Sek, **Gjovalin Marfana**
Drejtoria Juridike,.: Dr, **Manjola Doda**

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel &fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2262 Prot. Rrëshen me, 11.06. 2025

# RELACION

**Lënda:** Për "Miratimin në Parim të Draft Memorandum Partneriteti Dhe Bashkëpunimi Të Ndërsjellë, Ndërmjet Bashkisë Mirditë, Shqipëri dhe Bashkisë Pezinok, Sllovaki"

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Mirditë

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) "bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe perfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore", në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe Vendimin Nr. 734., datë 9.9.2015 "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore" pikat 9 dhe 11/c,
Bashkia Mirditë me ftesë të sajë, me datë 23 Tetor ka pritur ne vizitë SH.T.Z. Albin Otruba Ambasador i Sllovakisë në Shqipëri. Gjatë këtij takimi, Kryetari i Bashkisë Z. Albert Mëlyshi e informoi Sh.T.Z Albin Otruba mbi potencialin që mbart territori i Mirditës dhe mundësitë për zhvillim ekonomik.
SH.T.Z Albin Otruba shprehu vullnetin për bashkëpunime dhe projekte të përbashkëta dhe u ofrua në gjetjen e një bashkie/komune me karakteristika të ngjashme në Sllovaki për të bërë të mundur binjakëzimin mes dy njësive vendore.
Në letrën e datës 05.12.2024 e protokolluar në bashkinë Mirditë me Nr. 4565 Prot. datë 05.12.24, Ambasada Sllovake në Tiranë na përcjell informacionin se pas kontakteve me njësi vendore në Sllovaki, Qyteti i Pezinok (Bashkia e Pezinok) ka shprehur dëshirën dhe gadishmërinë për binjakëzim dhe bashkëpunim me bashkinë Mirditë (shkresa bashkëlidhur). Në një takim të zhvilluar në selinë e Ambasadës Sllovake në Tiranë me datë 18 Dhjetor 2024, Kryetari i Bashkisë i shoqëruar nga Përgjegjësi për Integrimin e Evropian dhe Projektet patën mundësi të diskutojnë më shumë dhe të mësojnë më shumë rreth Bashkisë së Pezinok dhe fushave të mundshme ku mund të bashkëpunohet. U ra dakort që të ndiqeshin hapat zyrtar për të vazhduar procesin e Binjakëzimit. Me datë 19.12.2024 me shkresen me nr. 4848 Prot, Bashkia Mirditë i drejtohet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme me "Kërkesë për Këshillim" në lidhje me binjakëzimin me Bashkinë e Pezinok. Pas ndjekjes së procedurave standarte të vepimit nga Ministria jonë dhe Ambasada

Shqiptare në Sllovaki, marrim përgjigjen me anë të shkresës me Nr.3417/1 Prot datë 28.04.2025 e protokolluar në Bashkinë Mirditë me Nr. 1754 Prot datë 30.04.2025 ku informohemi që të vazhdojmë procedurën e Binjakëzimit.
Po me datë 30.04.2025, stafi i Bashkisë Mirditë pregatit emailin të cilin i drejtohet Kryetarit të bashksë së Pezinok nga kryetari jonë i Bashkisë Z. Albert Mëlyshi për vendosjen e komunikimit direkt dhe për vijimin e procedurës së Binjakëzimit mes dy bashkive Respektive. Me datë 07.05.2025 marrim përgjigje nga Bashkia e Pezinok dhe më pas vazhdojnë diskutimet mes dy stafeve për formalizimin e draftit të dokumenti që do përmbyllë procesin e Binjakëzimit. Në dokumentin bashkëlidhur që gjendet në gjuhën Shqipe dhe atë Angleze do të gjeni edhe detaje ku do të përqëndrohen fushat e bashkëpunimit mes dy komuniteteve. Draft Miratimin në Parim të Draft Memorandum Partneriteti Dhe Bashkëpunimi Të Ndërsjellë, Ndërmjet Bashkisë Mirditë, Shqipëri dhe Bashkisë Pezinok, Sllovaki është i barazvlefshëm më një marrëveshje Binjakëzimi siq do ta gjeni të shprehur në pikat e draftit dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë.

Bashkëngjitur, do të gjeni **Draft Marrëveshjen** të përshtatur në gjuhën Shqipë nga Përgjegjësi për Integrimin Evropian dhe Projektet Gjovalin Marfana, **si edhe komunikimin shkresorë/email** të përmendura më sipër në relacion.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet:** P/ Sek, Gjovalin Marfana

**Drejtoria Juridike,.:** Dr, Manjola Doda

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel &fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITE

Nr. 3686/1 Prot. Rrëshen, 30.09.2024

Lënda: Ftesë për bashkëpunim

**Sh. T. Z. ALBIN OTRUBA**
**AMBASADORE E REPUBLIKES SLLOVAKE NË SHQIPËRI**
Adresa: Rruga Skenderbej Nr. 8 Tiranë, Shqipëri

*I Nderuar: Z. Albin Otruba*

Bashkia Mirditë ka prioritet të saj zbatimin e strategjive dhe planeve të zhvillimit vendorë nëpërmjet bashkëpunimit me qeverisjen qëndrore por dhe me donatorët.

Aktualisht Bashkia Mirditë ka kapacitete të mjaftueshme për të aplikuar në fondet e BE dhe po zbaton dy projekte në bashkëpunim me Komunën e Junikut dhe aktor të shoqërisë civile në kuadër të programit IPA II Cross Border Shqipëri-Kosovë por edhe synon të aplikojë dhe ne programet të tjera të BE për bashkëpunimin ndërkufitar nëpërmjet të cilave synon zbatimin e strategjive të saj për zhvillim.

Nisur nga marrëdhënjet shumë të mira ndërmjet Shqipërisë dhe Sllovakisë, jemi shumë të interesuar për të diskutuar me ju për mundësitë e bashkëpunimit me ambasadën Sllovake, për të gjetur mundësi reale për afrimin e bashkisë Mirditë me popullsi katolike me bashki Sllovake me realitete e resurse të ngjashme për të bashkëpunuar.

Nga sa më lart kërkojmë një takim me Ju për të diskutuar më hollësisht për mundësitë e bashkëpunimit dypalësh, në një kohë të përshtatëshme.

Singerisht!

**KRYETARI**
**ALBERT MËLYSHI**

**ME DELEGIM KOMPETENCASH**
**ME VENDIM**
**N/KRYETARI**
**Gjergj PRENGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

email: bashki@bashkiamirdite.gov.al tel &fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

EMBASSY
OF THE SLOVAK REPUBLIC
IN TIRANA

B. Dedaj
Gj. Marfana
Dt. 05.12.24

**Z. Albert Mëlyshi**
**Kryetar i Bashkisë Mirditë**
**Rruga Atë Gjergj Fishta**
**MIRDITË**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA MIRDITË

Tiranë, më 5.12.2024

I nderuar Kryetar i Bashkisë së Mirditës, i nderuar zoti Mëlyshi ,

Po ju shkruaj si vijimësi të vizitës sime të fundit në qytetin tuaj, gjatë së cilës diskutuam për mundësitë e një partneriteti midis qytetit të Mirditës dhe një qyteti sllovak. Kam kënaqesine t'ju informoj se qyteti i Pezinokut ka shprehur interes për të krijuar një partneritet me qytetin tuaj. Ne shohim këtë partneritet si një mundësi të jashtëzakonshme për të shkëmbyer përvoja, për të mbështetur zhvillimin rajonal dhe për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe midis vendeve tona.

Qyteti i Pezinokut, ngjashme me Mirditën, ka një trashëgimi të pasur historike, kulturore dhe natyrore. Ai njihet jo vetëm për prodhimin e verës, e cila është pjesë thelbesore e identitetit dhe ekonomisë së tij, por edhe për historinë e tij minerare. Pezinok ka një traditë të gjatë të nxjerrjes dhe përpunimit të metaleve të çmuara, e cila reflektohet në kulturën dhe traditat lokale. Përveç kësaj, Pezinok angazhohet në mënyrë aktive në mbrojtjen e biodiversitetit, zhvillimin e transportit ekologjik dhe përmirësimin e infrastrukturës, pasi ndodhet në natyrën e bukur të maleve të Karpateve të Ulëta.

Qyteti Pezinok është i interesuar për bashkëpunim në fusha të tilla si kultura dhe turizmi, shkëmbimi i përvojës në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës, ose mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe agroturizmit. Gjithashtu një mundësi tjetër bashkëpunimi mund të jetë organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore apo shkëmbimeve për të afruar komunitetet dhe banorët e këtyre qytetëve.

Ambasada e Republikës së Sllovakisë në Shqipëri është e gatshme të ndihmojë në çdo hap dhe iniciativë të mëtejshme në lidhje me zbatimin e këtij partneriteti. Me kënaqesi do t´ju asistojme në ndërmjetësimin e kontakteve, organizimin e eventeve apo aktiviteteve të tjera që do të ndihmojnë në thellimin e bashkëpunimit midis qyteteve të Pezinokut dhe Mirditës.

Presim me kënaqesi per hapat e ardhshme dhe jemi bindur se ky partneritet do t´i sjellë përfitime të dyja palëve.

Sinqerisht,

Albín Otruba

Ambasador

**BASHKIA MIRDITË**

Nr. 4848 Prot. Rrëshen me, 19.12.2024

**Lënda:** Kërkesë për këshillim

**MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**
**Adresa:** Bulevardi 'Gjergj Fishta', Nr 6. Tiranë

I/E Nderuar

Mbështetur në ligjin 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore, Neni 9, "Të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) "bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;" si dhe në Vendimin Nr. 734, datë 9.9.2015, "PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE" pikat 9 dhe 11c, ju infomojmë se:

Bashkia Mirditë me ftesë të sajë, me datë 23 Tetor ka pritur ne vizitë SH.T.Z. Albin Otruba Ambasador i Sllovakisë në Shqipëri. Gjatë këtij takimi, Kryetari i Bashkisë z. Albert Melyshi e informoi Sh.T.Z Albin Otruba mbi potencialin që mbart territori i Mirditës dhe mundësitë për zhvillim ekonomik.

SH.T.Z Albin Otruba shprehu vullnetin për bashkëpunime dhe projekte të përbashkëta dhe u ofrua në gjetjen e një bashkie/komune me karakteristika të ngjashme në Sllovaki për të bërë të mundur binjakëzimin mes dy njësive vendore.

Në letrën e datës 05.12.2024 e protokolluar në bashkinë Mirditë me Nr. 4565 Prot. datë 05.12.24 na përcjell informacionin se pas kontakteve me njësi vendore në Sllovaki, Qyteti i Pezinok (Bashkia e Pezinok) ka shprehur deshiren dhe gadishmërinë për binjakëzim dhe bashkëpunim me bashkinë Mirditë (shkresa bashkëlidhur).

Kërkojmë mendimin tuaj në lidhje me binjakëzimin ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Bashkisë së Pezinok, si dhe asistencen tuaj në lidhje me proçedurat ligjore që duhet të ndjekim në përmbushjen e këtij binjakëzimi.

Mbetemi në pritje të një mendimin nga ana juaj!
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Konc: Gj. Marfana**

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel &fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

Nr. 1754 Prot
Dt. 30.04.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE POLITIKE DHE STRATEGJIKE**
**DREJTORIA E BASHKËPUNIMIT DYPALËSH EVROPIAN**

Nr. 3417/1 Prot.,
Indeksi B

Tiranë, më 28.04.2025

Lënda: Lidhur me binjakëzimin ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Bashkisë Pezinok.

**BASHKISË MIRDITË**
**Z. ALBERT MËLYSHI**
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Rrëshen**

I nderuar Zoti Albert Mëlyshi, Kryetar,

Në vijim të kërkesës suaj për këshillim lidhur me procedurat e binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Bashkisë Pezinok në Sllovaki, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjellë këtë kërkesë pranë Ambasadës së Shqipërisë në Bratislavë me qëllim ndërmjetësimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet dy bashkive.

Sa më sipër, së fundmi jemi informuar nga ambasada se Ambasadori i Shqipërisë në Bratislavë, z. Arten Hanku, ka zhvilluar një takim me Kryetarin e Bashkisë Pezinok, z. Roman Macs, posaçërisht për të diskutuar lidhur me kërkesën tuaj.

Kryetari Macs mirëpriti propozimin e Bashkisë Mirditë për binjakëzimin e dy qyteteve duke evidentuar gjithashtu se qyteti Pezinok ka binjakëzime të ngjashme me 6 qytete të tjera evropiane. Referuar procedurave teknike dhe ligjore, Kryetari Macs u shpreh se fillimisht mirëpret një kërkesë zyrtare për binjakëzim nga Bashkia Mirditë e cila do të shqyrtohet në një kohë të shpejtë dhe pozitivisht. Më pas do të vijohet me përgatitjen e Memorandumit të Binjakëzimit ndërmjet dy qyteteve, i cili pas miratimit në Këshillin bashkiak do të nënshkruhet nga Kryetarët e Bashkive në një vizitë të mundshme në Pezinok ose Mirditë.

Për të vijuar me procedurat e mëtejshme, u ra dakord gjatë takimit që të vendoset komunikimi i drejtpërdrejtë midis dy Bashkive (kabineteve). Bashkëlidhur gjeni kontaktet e Kryetarit të Bashkisë Pezinok, z. Roman Macs, për të filluar dhe zhvilluar ndërveprimin e drejtpërdrejtë mes dy bashkive.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**ARMAND SKAPI**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Nr. 6, Tiranë. Tel: +355 (0) 422364090
www.punetejashtme.gov.al info@mfa.gov.al

Outlook

## Re: Official Request for Twinning with the Municipality of Pezinok from the Municipality of Mirdita, Albania

**From** Gjovalin Marfana <Gjovalin.Marfana@bashkiamirdite.gov.al>
**Date** Fri 16/05/2025 09:56
**To** Kamila Korcekova <Kamila.Korcekova@msupezinok.sk>
**Cc** Albert Melyshi <Albert.Melyshi@bashkiamirdite.gov.al>; emb.tirana@mzv.sk <emb.tirana@mzv.sk>; Arten Hanku <Arten.Hanku@mfa.gov.al>; Besian Dedaj <Besian.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Fjoralba Dedaj <Fjoralba.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Elisara Gjini <Elisara.Gjini@bashkiamirdite.gov.al>; Kudelova Erika <erika.kudelova@msupezinok.sk>; Ardiana Laska <Ardiana.Laska@bashkiamirdite.gov.al>; Stetka Peter <Peter.Stetka@msupezinok.sk>; Macs Roman <roman.macs@msupezinok.sk>; Volnerova Jarmila <Jarmila.Volnerova@msupezinok.sk>

1 attachment (257 KB)
Memorandum City of Pezinok and Mirditë Municipality 2.docx;

Dear Kamila,

On behalf of the Mayor of Mirditë Mr. Albert Mëlyshi thank you for the prompt reply.
Following up on your email, kindly find attached the Memorandum revised by our staff.
If the small edits made by our side are acceptable for you, I propose to move forward with introducing the draft memorandums to our respective council for approval.

Look forward to receiving your feedback and moving forward with this partnership.
Best Regards,

**Gjovalin Marfana**
***Përgjegjës i Njësisë së Integrimit Evropian dhe Projekteve***
***Head of EU Integration and Projects Unit***
**Bashkia Mirditë**
**Municipality Mirditë**
**+355695563624**

---

**From:** Kamila Korcekova <Kamila.Korcekova@msupezinok.sk>
**Sent:** 07 May 2025 16:31
**To:** Albert Melyshi <Albert.Melyshi@bashkiamirdite.gov.al>
**Cc:** emb.tirana@mzv.sk <emb.tirana@mzv.sk>; Arten Hanku <Arten.Hanku@mfa.gov.al>; Besian Dedaj <Besian.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Gjovalin Marfana <Gjovalin.Marfana@bashkiamirdite.gov.al>; Fjoralba Dedaj <Fjoralba.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Elisara Gjini <Elisara.Gjini@bashkiamirdite.gov.al>; Kudelova Erika <Erika.Kudelova@msupezinok.sk>; Ardiana Laska <Ardiana.Laska@bashkiamirdite.gov.al>; Stetka Peter <Peter.Stetka@msupezinok.sk>; Macs Roman <Roman.Macs@msupezinok.sk>; Volnerova Jarmila <Jarmila.Volnerova@msupezinok.sk>
**Subject:** RE: Official Request for Twinning with the Municipality of Pezinok from the Municipality of Mirdita, Albania

Niektorí príjemcovia tejto správy nedostávajú často e-maily z adresy kamila.korcekova@msupezinok.sk. Zistite, prečo je to dôležité

**KUJDES:** Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Dear Chairman Mr. Mëlyshi,

on behalf of Mayor Mr. Roman Mács, I would like to express our sincere appreciation for your email and the interest of the Municipality of Mirditë in establishing a twinning partnership with the City of Pezinok.

We are pleased to confirm that we fully support this initiative and are excited about the opportunity to collaborate on cultural and agricultural exchanges, as well as to apply for European projects that will benefit our municipalities.

Attached, you will find our proposed memorandum for your review. Please go through it, and feel free to make any necessary additions or adjustments.

We look forward to receiving your feedback and moving forward with this partnership.

Thank you once again for reaching out, and we look forward to the future cooperation.

Best regards ,

S úctou a prianím pekného dňa


**Ing. Kamila KORČEKOVÁ**

asistentka primátora

00421 33 6901 122 | kamila.korcekova@msupezinok.sk

00421940652314 | www.pezinok.sk

**Mestský úrad Pezinok**
Kancelária č. 2.03
Radničné námestie 7,
902 14 Pezinok

**Mesto Pezinok**
Radničné námestie 44/7, 902 14 Pezinok
IČO: 00305022, DIČ: 2020662226


Našim cieľom je komunikovať elektronicky, pridajte sa k nám.

**From:** Albert Melyshi <Albert.Melyshi@bashkiamirdite.gov.al>
**Sent:** Wednesday, April 30, 2025 2:20 PM
**To:** Macs Roman <Roman.Macs@msupezinok.sk>; Kudelova Erika <Erika.Kudelova@msupezinok.sk>
**Cc:** emb.tirana@mzv.sk; Arten Hanku <Arten.Hanku@mfa.gov.al>; Besian Dedaj <Besian.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Gjovalin Marfana <Gjovalin.Marfana@bashkiamirdite.gov.al>; Fjoralba Dedaj <Fjoralba.Dedaj@bashkiamirdite.gov.al>; Elisara Gjini <Elisara.Gjini@bashkiamirdite.gov.al>; Ardiana Laska <Ardiana.Laska@bashkiamirdite.gov.al>
**Subject:** Official Request for Twinning with the Municipality of Pezinok from the Municipality of Mirdita, Albania

Dear Chairman Mr. Roman MACS,

I am Albert Mëlyshi, Chairman of the Municipality of Mirditë from the Republic of Albania. Regarding your city, I had the opportunity to learn about it from his Excellency, the Ambassador of Slovakia to Albania, Mr. Albin Otruba, in the context of the embassy in Tirana last December, following his October visit to Mirditë of that same year. During our discussion with Mr. Otruba and the embassy staff, we also had the chance to view and learn a bit about the Municipality of Pezinok through videos—just as I assume you may have learned a little bit more about the Municipality of Mirditë from his Excellency, the Ambassador of Albania in Bratislava, Mr. Arten Hanku.

Through this email, please allow me to directly express the request of the Municipality of Mirditë for twinning with the Municipality of Pezinok under your administration, so we can cooperate with you in

order to exchange cultural and agricultural experiences and have the opportunity to apply for European Projects so we can address the needs of our municipalities.

In order to proceed with the appropriate procedures, please note that attached to this email you will also find the list of my staff contacts who will follow up on all the necessary procedures here in Albania.

Awaiting your reply,
Sincerely,
Albert Mëlyshi
Chairman, Municipality of Mirditë

**KURSEJMË ENERGJINË QË TA KEMI!**

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

---

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct



**MEMORANDUM PËR PARTNERITET DHE BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË**

**Qyteti i Pezinok**
Përfaqësuar nga: JUDr. Romanom Mácsom, kryetar bashkie
adresa: Radničné námestie 44/7, 902 14 Pezinok
ID e kompanisë: 00305022
ID e Tatimit: 2020662226

**dhe**

**Bashkia Mirditë**
(English: Municipality of Mirditë)
*Përfaqësuar nga: Albert Mëlyshi, Kryetari i Bashkisë*
adresa: Sheshi Abat Doçi, 4601 Rrëshen, Mirditë
ID e kompanisë: K39004005W
ID e Tatimit: K39004005W

kanë hyrë në këtë memorandum

## Neni I.
## Subjekti i Memorandumit

Përfaqësuesit e qytetit të Pezinokut dhe Bashkisë së Mirditës, si partnerë, shprehin vullnetin e tyre të lirë për të hyrë në këtë Memorandum Partneriteti dhe Bashkëpunimi të Ndërsjellë (në tekstin e mëtejmë i referuar si "Memorandumi") bazuar në deklaratën e interesave, qëllimeve dhe fushave të përbashkëta në të cilat shohim potencial të madh për pasurim të ndërsjellë.

## Neni II.
## Fusha e bashkëpunimit

Të dy partnerët ndajnë një histori minerare, tradita të vreshtarisë dhe prodhimit të verës, si dhe potencial për zhvillimin e turizmit. Bazuar në këtë, ata shprehin interesin e tyre për të krijuar dhe zhvilluar bashkëpunim të ndërsjellë në:

1- Bashkëpunimi në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe të koordinuara të BE-së,
2- Ndarja e përvojave në fushat e qeverisjes vendore dhe adresimi i sfidave të përbashkëta,



Përshtati në gjuhën Shqipe: Gjerolin Marfand

3- Krijimi i partneritetit midis shkollave, klubeve sportive, institucioneve të Trashëgimisë Sociale dhe Kulturore,

4- Të krijojmë dhe ndajmë kontakte të sektorit të biznesit me një fokus të veçantë në turizëm dhe ekoturizëm,

5- Krijimi i urave për bashkëpunim midis shoqatave të minierave, funksionimi i organizatave jofitimprurëse etj.,

**Neni III.**
**Dispozitat përfundimtare**

1. Ky Memorandum lidhet për një periudhë të pacaktuar
2. Memorandumi është ekuivalente me një Marrëveshje Binjakëzimi.
3. Angazhimi i palëve pjesëmarrëse i shprehur në këtë Memorandum mund të ndërpritet vetëm me një marrëveshje me shkrim të palëve ose me një njoftim me shkrim për ndërprerje pa deklaruar arsye, të paraqitur nga secila palë, me një afat njoftimi njëmujor që fillon nga dita e parë e muajit pas dorëzimit të njoftimit.
4. Ky Memorandum është lidhur në bazë të Rezolutës Nr. .../2025 të Këshillit të Qytetit të Pezinokut, datë DD.MM.2025 dhe rezolutave Nr. ___/2025 të Këshillit Bashkiak të Mirditës, datë DD.MM.2025.
5. Pasi e kanë lexuar siç duhet këtë Memorandum dhe janë njohur me përmbajtjen e tij, palët pjesëmarrëse deklarojnë se e kuptojnë përmbajtjen dhe qëllimin e tij, se ai pasqyron qëllimin e tyre të ndërsjellë dhe se e nënshkruajnë atë lirisht dhe seriozisht, jo nën presion ose kushte të pafavorshme.
6. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja palët pjesëmarrëse dhe hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Regjistrin Qendror të Kontratave të mbajtur nga Zyra e Qeverisë së Republikës Sllovake.".

**E bërë**

| | |
|---|---|
| Në Pezinok, me ......./...../....../2025 | Në Rrëshen, me ........./....../ 2025" |
| Nr. _______. Protokoll, | Nr. _______. Protokoll |
| **KRYETAR I BASHKISË PEZINOK** | **KRYETAR I BASHKISË MIRDITË** |
| **JUDR. ROMAN MÁCS** | **ALBERT MËLYSHI** |
| ____________________ | ____________________ |
| (firma dhe vula) | (firma dhe vula) |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

# MEMORANDUM
# OF PARTNERSHIP AND MUTUAL COOPERATION

**City of Pezinok**
represented by: JUDr. Romanom Mácsom, primátorom
registered office: Radničné námestie 44/7, 902 14 Pezinok
Company ID: 00305022
Tax ID: 2020662226

**and**

**Mirditë Municipality**
(Albanian: Bashkia Mirditë)
*Represented by: Albert Mëlyshi, Kryetari i Bashkisë*
Registered office: Square Abat Doçi, 4601 Rrëshen, Mirditë
Company ID: K39004005W
Tax ID: K39004005W

have entered into this memorandum

## Article I.
## Subject of the Memorandum

The representatives of the city of Pezinok and the Municipality of Mirditë, as partners, express their free will to enter into this Memorandum of Partnership and Mutual Cooperation (hereinafter referred to as the „ Memorandum ") based on the declaration of shared interests, goals, and areas in which we see great potential for mutual enrichment.

## Article II.
## Area of cooperation

Both partners share a mining history, viticulture and winemaking traditions, as well as potential for tourism development. Based on this, they express their interest in establishing and developing mutual cooperation in:

1- Cooperation in the design and implementation of joint and coordinated EU projects,
2- Sharing experiences in the areas of local governance and addressing common challenges,

3- Creating partnership between schools, sports club, Social and Cultural Heritage institutions,
4- Create and share contacts of the business sector with a keen focus on tourism and eco-tourism,
5- Creating bridges for cooperation among mining associations, operation of non-profit organizations etc,

**Article III.**
**Final Provisions**

1. This Memorandum is concluded for an indefinite period
2. It is equivalent to e Twining Agreement.
3. The commitment of the participating parties expressed in this Memorandum may be terminated only by a written agreement of the parties or by a written notice of termination without stating a reason, submitted by either party, with a one-month notice period commencing on the first day of the month following the delivery of the notice.
4. This Memorandum is concluded based of Resolution No. .../ 2025 of the Pezinok City Council dated DD.MM.2025 and resolutions No. ___/2025 of the Municipal Council of Mirditë dated DD.MM.2025
5. After having duly read this Memorandum and familiarized themselves with its content, the participating parties declare that they understand its content and purpose, that it reflects their mutual intent, and that they enter into it freely and seriously, not under duress or disadvantageous conditions
6. This Memorandum becomes valid on the date of its signature by both participating parties and enters into effect on the day following its publication in the Central Register of Contracts maintained by the Government Office of the Slovak Republic.".

**Done**

In Pezinok, on .................. 2025

Nr. _______. Protocol,

**MAYOR OF PEZINOK**

**JUDR. ROMAN MÁCS**

_______________________

(signature and stamp)

In Rrëshen, on ................. 2025"

Nr. _______. Protocol

**MAYOR OF MIRDITË**

**ALBERT MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

_______________________

(signature and stamp)